



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:072854
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05613079

K.DH.SH.II.nr.246/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjellësi “Prishtina” me seli ne Prishtinë rr.”Hazir Shala” nr.4, ndaj debitorit “KEDS KKDFEE” sh.a, me seli ne Prishtinë rr.’Ilaz Kodra”, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1044/22 dt. 17.11.2023, me datën 23.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjellësi “Prishtina” me seli ne Prishtinë rr.”Hazir Shala” nr.4, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1044/22 dt. 17.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1044/22 dt. 17.11.2023, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit “KEDS KKDFEE” sh.a, me seli ne Prishtinë rr.’Ilaz Kodra” dhe e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.453/21 dt.25.03.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferri me seli ne Prishtinë si dhe ka përfunduar procedurën ne këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak te shkeljes esenciale te dispozitave te procedurës civile, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkallës se dytë,

këtë ankesë ta aprovoj, aktvendimin e atakuar ta prish dhe çështjen ta kthej ne rivendosje ose aktvendimin e atakuar ta ndryshoj.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” me seli ne Prishtinë rr.”Hazir Shala” nr.4, me datën 24.03.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit “KEDS KKDFEE” sh.a, me seli ne Prishtinë rr.’Ilaz Kodra”, në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstraktit te verifikuar nga librat afarist te kontabilitetit nen shifrën 179. Përmbartuesi Privat Isa Gacaferri nga Prishtina, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.453/21 dt.25.03.2021, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te detyrimit për furnizim me ujë te pijshëm, ti paguaj shumën prej 5,594.75 euro, ne afat prej 7 ditësh nga dita pranimit te këtij urdhri si si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 07.04.2021, me pretendimin se kartela financiare nuk pasqyron sakte gjendjen reale te pagesave te cilat i ka bere debitori për furnizim me ujë , urdhri përmbartimor është përfshirë ne shkelje te LPP dhe se ne rast se propozimi i cili nuk është i plotësuar me kërkesat nga neni 38 i LPP organi përmbartues duhet te veproj konform nenit 102 te LPK, kartela financiare është ne shpërputhje me nenin 29 te LPP, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhri përmbartimor te anulohet ndërsa kreditori te detyrohet te paguaj shpenzimet e procedurës.

Përgjigje ne prapësim ka paraqitur kreditori me datën 08.04.2021, me arsyetimin se dëshmitë e pagesave qe debitori i ka bashkangjitur prapësimi se kinse e ka paguar borxhin nuk qëndrojnë sepse ne këto pagesa nuk është specifikuar se për cilin kod është kryer pagesa sepse KEDS ka gjithsej 23 fatura te ndryshme me kode te ndryshme dhe se nga specifikacioni nga BKT ne asnjë moment nuk është bere pagesa ne kodin 179 por ne kode tjera. Pohimet e debitori janë te paqëndrueshme sepse ne asnjë formë nuk ka dëshmuar se i ka kryer obligimet për kodin 179 KEDS KKDFEE ashtu siç parasheh rregullorja nr.10/2019 për Standardet Minimale te Shërbimeve te Ujit ne Kosovës, shton se kartela e konsumatorit është dokument i besueshëm dhe LPP e njeh atë, andaj propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit si te pabazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkalles se parë, pas vlerësimit të prapësimi dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP, nr.1044/22 dt.17.11.2023, me të cilin ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Ka gjetur se ekstrakti i verifikuar nga librat afarist nr.179 ne te cilin mbështetet propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për te qenë dokument i besueshëm nga neni 29 par.3 dhe nenit 37 te LPP sepse ky dokumentin nuk ka përshkruar shërbimet te cilat kanë qenë objekt i faturës si dhe periudha

kohore për te cilën kërkohet përmbushja e detyrimit, nga ekstrakti rezulton borxhi ne shumen prej 5,594.75 euro për periudhën kohore prej 01.01.2016 deri me 22.03.2021 ndërsa ne përmbajtje te këtij ekstrakti nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 30.12.2013 me ç ‘rast nuk dihet fare për cilat shërbime dhe për cilën periudhe kohore është grumbulluar borxhi ne fjalë, andaj fakti se dokumenti mbi bazën e te cilit është lejuar përmbarimi nuk ka tipare te përmbarueshmerisë si rrjedhojë kësaj gjykata nuk i shqyrtoi pretendimet tjera te debitorit ne prapësim dhe ato te kreditori ne përgjigje ne prapësim ashtu qe vendosi si ne dispozitiv te aktvendimit.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata shkalles se dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkalles se Dytë, bazuar nga shkresat ne lëndë konstaton se propozimi për përmbarim është lejuar ne bazë Kartelës financiare te Konsumatorit me shifrën 179 me shumë te detyrimit prej 5,594.75 euro. Mirëpo analizuar propozimin për përmbarim nuk rezulton periudha kohore për te cilën kreditori kërkon detyrimin ndaj debitorit, ndërsa dokumenti mbi bazën e te cilit është lejuar përmbarimi del te mos jetë ne përputhje me dispozita ligjore përkatësisht nenin 29 par.3 te LPP i cili përcakton se *“Dokumentit i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*, pasi ne rastin konkret është e paqartë se cila është shuma e saktë e detyrimit te debitorit ndaj kreditorit sepse ne këtë dokument publik është e përshkruar periudha kohore nga data 01.01.2013 deri me 22.03.2021, mirëpo ne fakt ne përmbajtje të dokumentit shifet se nuk e ka te përfshirë detyrimin për periudhën 01.01.2013 deri me datën 30.12.2013, nga del se ky dokument te mos plotëson kushtet ligjore për te qenë i ekzekutueshëm, pasi nuk dihet se për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi ne fjalë dhe me këtë edhe detyrimi i debitorit ndaj kreditorit. Andaj mbi këtë bazë kjo gjykatë e pranon përfundimin juridik te gjykatës e shkalles se parë lidhur me gjendjen faktike te konstatuar nga e njëjta.

Kjo gjykatë ka analizuar edhe pretendimet e kreditorit por të njëjtat vlerësoj se nuk janë relevante për një vendosje ndryshe, ashtu qe i ka refuzuar ndërsa aktvendimin e atakuar e ka vërtetuar.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Numri i lëndës: 2021:072854
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05613079

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.246/24, me datë 23.04.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi